




**MEZ
DOI
4A0.**

Vizioni i medias në Ballkanin
Perëndimor për vitin 2040



Në vitin 2040, gazetarët profesionistë dhe të pavarur do të jenë të sigurt dhe të mbrojtur nga çdo ndikim negativ. Teknologjia e përdorur në mënyrë etike luan një rol të rëndësishëm për të ndihmuar median të përmbushë detyrën e saj ndaj interesit publik dhe të jetë zëri i qytetarëve për një shoqëri të mirinformuar, gjithëpërfshirëse dhe demokratike.

1

HYRJJE

Në tetor të vitit 2023 ka filluar projekti “Media 2040: Fuqizimi i avokuesve të rinj për lirinë e medias në Ballkanin Perëndimor” si një rrjet prej gjashtë universitetesh publike në Ballkanin Perëndimor. Pjesë e rrjetit janë një grup prej 40 studentësh të gazetarisë dhe komunikimit nga Novi Sadi, Podgorica, Prishtina, Sarajeva, Shkodra dhe Shkupi. Ne punuam së bashku për të parashikuar të ardhmen e medias - një të ardhmeje për vitin 2040 ku të rinjtë dëshirojnë të punojnë si profesionistë të medias me përvojë.

Për të realizuar vizionin tonë, ne bëmë skanimin e horizontit - përkatësisht procesin e detektimit të situatës dhe prirjeve aktuale në fushën e medias. Në mënyrë të veçantë, vëzhguam se çfarë është duke ndodhur në lidhje me pesë dimensionet kryesore të sistemeve mediatike. Gjatë këtij procesi, organizuam një forum online me gazetarë dhe ekspertë të politikave mediatike, teknologjisë mediatike dhe biznesit mediatik. Gjetjet nga kërkimi i horizontit janë formuluar si konkluzione kryesore që lidhen me:



Pas krijimit të një pasqyre të përgjithshme të tendencave, kemi zhvilluar një seminar pesëditor në Shkodër për të krijuar një vizion të përbashkët për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Nëpërmjet një procesi interaktiv dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë udhëzimet profesionale, formuluar vizionin dhe diskutuam për sfidat dhe faktorët që mund të na ndihmojnë të realizojmë vizionin.

Megjithëse vërehen tendenca të ngjashme në të gjithë Ballkanin Perëndimor, çdo sistem mediatic ka specifikat e veta dhe problemet nuk kanë të njëjtin nivel urgjence. Si rrjedhojë, ky vizion duhet konsideruar si një kornizë e përgjithshme që duhet përpunuar më tej për të marrë parasysh tendencat specifike lokale dhe kompetencat e palëve të interesit.



2

VIZIONI DHE FJALËT KYÇE

Në vitin 2040, gazetarët profesionistë dhe të pavarur do të jenë të sigurt dhe të mbrojtur nga çdo ndikim negativ. Teknologjia e përdorur në mënyrë etike luan një rol të rëndësishëm për të ndihmuar median të përmbushë detyrën e saj ndaj interesit publik dhe të jetë zëri i qytetarëve për një shoqëri të mirinformuar, gjithëpërfshirëse dhe demokratike.

PROFESIONALIZMI, PAVARËSIA, SIGURIA DHE LIRIA E GAZETARËVE

Deri në vitin 2040, gazetarët do të punojnë në një mjedis pa kërcënime, kanosje dhe forma të tjera presioni, duke përfshirë ato që ndodhin në internet me anonimitet të dukshëm. Ata operojnë të pavarur, të mbrojtur nga ndikimi i panevojshëm politik dhe ekonomik dhe të mbrojtur nga një kuadër i fortë ligjor dhe norma sociale që nxisin vlerën e lirisë së medias. Shoqatat e fuqishme të gazetarëve nxisin sjelljen profesionale dhe solidaritetin, sindikatat e fuqishme të gazetarëve sigurojnë kushte të mira pune, ndërsa këshillat e institucionalizuara dhe efikase të shtypit rikthejnë besimin e qytetarëve tek media.

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË MËNYRË ETIKE

Teknologjia në vitin 2040 do të shërbejë si një instrument i fuqishëm për përmirësimin e punës së gazetarëve dhe komunikimit publik në përgjithësi. Teknologjia përdoret në mënyrë etike duke respektuar privatësinë, saktësinë dhe autenticitetin, dhe duke siguruar transparencë të plotë. Inovacionet në fushën e inteligjencës artificiale, analizës së të dhënave dhe platformave digjitale i nxisin gazetarët të zbulojnë histori, të analizojnë raste të vështira dhe të angazhojnë audiencën në mënyra kuptimplota.

ROLI I MEDIAS NË SHËRBIM TË INTERESIT PUBLIK

Deri në vitin 2040, media do të jetë zëri i qytetarëve, duke avokuar interesin publik në raportimin e tyre dhe duke kërkuar llogari nga pushtetarët. Interesi publik është i rrënjosur në vendimet editoriale, veçanërisht në shërbimet e mediave publike që janë në shërbim të komuniteteve të ndryshme. Interesi publik mbrohet nga rregullimi i pavarur dhe efikas i medias, ku roli kryesor i një gazetari të pavarur duhet të jetë sigurimi i një pluralizmi mediatik, transparenca e pronësisë dhe respektimi i plotë i të drejtave të njeriut.


SHOQËRI TË MIRINFORMUARA, GJITHËPËRFSHIRËSE DHE DEMOKRATIKE

Nëpërmjet raportimit në interes të publikut, deri në vitin 2040 media do të nxisë qytetarët e mirinformuar dhe të fuqizuar për të marrë vendime, për të marrë pjesë në komunikimin publik dhe për të përkrahur të mirën publike. Arsimi formal dhe joformal ofron njohuri, aftësi dhe kompetenca për nivele të larta të edukimit mediatik. Media nxit dialogun ndërmjet perspektivave të ndryshme -politike, etnike apo fetare, dhe vepron si katalizator për një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe demokratike.

SKENARI MEDIATIK NË VITIN 2040: KAPËRCIMI I SFIDAVE DHE PËRFSHIRJA E FATORËVE MUNDËSUES

Sfidat që duhen kapërcyer për të realizuar vizionin e së ardhmes janë si në vijim:

- Palët politike dhe qeveritë e kontrollojnë fuqishëm median, duke ndikuar tek media përmes financimeve dhe reklamave shtetërore, emërimit të organeve rregullatore dhe shpifjeve ndaj gazetarëve.
- Sulmet ndaj gazetarëve zvogëlojnë hapësirën për dialog publik duke mos u lënë hapësirë gazetarëve kritikë dhe hulumtues të shprehin opinionin e tyre.
- Konflikti (potencial) mbetet një sfidë e vazhdueshme në rajon dhe i shkatërron komunitetet, duke ndikuar në polarizimin e mediave dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes.
- Ikja e trurit ndikon në sistemet mediatike sepse sjell largimin e gazetarëve të rinj dhe të publikut në moshë të re, të cilët janë të arsimuar dhe kanë njohuri të larta rreth përmbajtjes mediatike.
- Gjendja e dobët ekonomike e gazetarëve, mediave dhe qytetarëve prek të gjithë sistemet mediatike. Profesionit i gazetarisë është drejt zhdukjes, sepse nuk ka të rinj të gatshëm ta ushtrojnë atë. Media është e orientuar drejt reklamave dhe përmbajtjeve që prodhohen lehtë dhe janë kryesisht sensacionale. Qytetarët nuk kanë fonde të mjaftueshme për të mbështetur drejtpërdrejt mediat.
- Monopoli i tregut ka efekte të dëmshme në komunikimin publik, sepse pengon përfaqësimin e këndvështrimeve të ndryshme në media.
- Inteligjenca artificiale përbën një kërcënim për komunikimin publik, pasi mund të përdoret për manipulimin dhe keqinformimin e qytetarëve.
- Rrjetet sociale përshpejtojnë kontaminimin e informacionit (keqinformimi, gjuha e urrejtjes, shkeljet e privatësisë) dhe paraqesin sfida për modelin e biznesit të medias.
- Gazetaria qytetare konkurron me gazetarinë tradicionale për vëmendjen e audiencës, duke ofruar informacione që mund të dekontekstualizohen, të njëanshme ose polarizuese.
- Besimi te gazetarët, lajmet dhe mediat e tyre është në rënie, duke i bërë qytetarët më të ndjeshëm ndaj burimeve alternative të lajmeve dhe keqinformimeve, dhe duke sjellë uljen e pjesëmarrjes politike.



Faktorët mundësues që mund të ndihmojnë në krijimin e një të ardhmeje potenciale:

- Organet rregullatore merren me problemet e teknologjisë dhe medias online, të udhëhequr nga interesi publik, parimet e të drejtave të njeriut dhe transparencën.
- Gazetarët e guximshëm dhe të vendosur promovojnë standardet profesionale dhe veprimet etike, pavarësisht presioneve që vijnë nga politika ose si rezultat i ekonomisë.
- Organet gjyqësore që ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrën e duhur ofrojnë garanci për lirinë e fjalës.
- Respekti i ndërsjellë dhe bashkëpunimi mes gazetarëve nxit kulturën e profesionalizmit dhe solidaritetit.
- Edukimi mediatik, i përfshirë në arsimin formal dhe joformal, dhe i promovuar nga vetë media, i bën qytetarët përdorues të përgjegjshëm, kritikë dhe kërkues të lajmeve.
- Zhvillimet teknologjike po e zhvillojnë gazetarinë, duke ndihmuar në mbledhjen e lajmeve, gazetarinë investigative, shpërndarjen e lajmeve përmes kanaleve të shumta dhe angazhimin e audiencës në mënyra të ndryshme.
- Inteligjenca artificiale i ndihmon gazetarët për kryerjen e detyrave të vështira dhe krijimin e formateve dhe përmbajtjeve të reja tërheqëse që tërheqin dhe angazhojnë audiencën.
- Rrjetet sociale mundësojnë që mediat dhe gazetarët të arrijnë grupe të ndryshme të audiencës dhe mundësojnë ndërveprim dhe pjesëmarrje më të madhe në dialogun publik.
- Gazetaria qytetare e plotëson gazetarinë tradicionale duke siguruar autenticitetin dhe diversitetin e zërave në sferën publike.
- Bashkimi Evropian promovon lirinë dhe pluralizmin e medias, si dhe përdorimin etik të teknologjisë, ndërsa përmes procesit të anëtarësimit ofron një bazë legjislative dhe mbështetje në zbatimin e legjislacionit që lidhet me median dhe teknologjinë.

Kapërcimi i sfidave dhe përfshirja e faktorëve mundësues janë thelbësore për realizimin e vizionit të mediave dinamike, të pavarura dhe etike në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2040. Nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta për zgjidhjen e sfidave emergjente dhe duke u mbështetur në faktorët mundësues, palët e interesit mund të punojnë për të krijuar një mjedis në të cilin gazetarët mund të punojnë lirisht, ku teknologjia përdoret në mënyrë etike dhe media shërben si një katalizator për shoqëritë gjithëpërfshirëse dhe vërtet demokratike.



Projekti mbështetet nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Beograd përmes Fondit Holandez për Bashkëpunim Rajonal – programi MATRA.



**FAKULTET
POLITICKIH
NAUKA**
UNIVERZITET U SARAJEVU
MCMXXLIX

UNIVERZITET
CRNE GORE



FAKULTET
POLITICKIH
N A U K A
PODGORICA



Kingdom of the Netherlands

medijskestudije.ff.uns.ac.rs/media2040/